

VENDIM
Nr. 735, datë 23.11.2022

PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT NGA AGJENCIA E
OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA TEK AGJENCIA
SHTETËRORE E KADASTRËS, TË PASURISË NR. 50/17-N, ZONA KADASTRALE
8605, VLORE, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 448, DATË
16.6.2005, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit nga Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të pasurisë nr. 50/17-N, zona kadastrale 8605, Vlorë, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar.

3. Agjencisë Shtetërore të Kadastrës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pasurisë, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ia japë atë në përdorim të tretëve.


4. Ngarkohen Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MIRATOHET
DREJTORI I SHITES QENDRORE TE FA
Në mungesë
KRYETARE E DEGES EKONOMIKE
Elida LEKA

Planimetria e objektit
Kati përfaqshues
Sipërfaqja TOTALE = 715m²
Shkalla 1:150



REPUBLIKA E SHQIPËSË	ENEA SHKOMB
MINISTRI I Mbrojtjes	ERMAL MUSQI
PROKUROR I GJ. L.	KALIN DOKI
SHTETIA E USHTARAKEVE	